



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS  
GJUHË C (1) Frengjisht

**Ngarkesa:** kredite : 3 ECTS; leksione - /seminare: 30  
**Viti akademik / semestri kur zhvillohet:** Viti I, Semestri: I  
**Lloji i lëndës:** Lëndë me detyrim  
**Programi i studimit:** Master i Shkencave në “Përkthim teknik, letrar dhe Interpretim”  
**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektiva të përgjithshme lëndore:** Ky modul do t’i japë studentit mundësinë të përvetësojë dhe përmirësojë kompetencat gjuhësore dhe leksikore, kompetencat e të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim dhe me gojë nëpërmjet studimit të teksteve të ndryshëm (informues, përshkrues, shpjegues, argumentues) dhe analizës leksikore, gramatikore dhe kulturore.

Zhvillimi i kompetencave përcakton zgjedhjet metodologjike të mëposhtme: Katër kompetencat: të kuptuarit, të shkruarit, të lexuarit dhe të folurit do të trajtohen në mënyrë të ekuilibruar, bazuar në tekste të ndryshme. Do të favorizohet reflektimi i studentit në praktikat gjuhësore me shkrim dhe me gojë. Qasja pedagogjike bazohet në vëzhgimin, në analizën dhe në ndërveprimin. Studenti do të punojë në mënyrë të pavarur në lidhje me aspektet gjuhësore të teksteve

**Objektiva specifike lëndore:**

- Të thellojë dhe të përmirësojë njohuri thelbësore të strukturave gjuhësore të gjuhës frënge në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar dhe saktësuar specifikat fonetike;
- Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës, si dhe shumë strategji të të nxëniet që do të çojnë progresivisht drejt autonomisë gjuhësore;
- Të zhvillojë aftësitë për të zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat, për të argumentuar, shpjeguar dhe arsyetuar opinionet, debatet, projektet dhe veprimet në mënyrë koherente për të folur për veprimtaritë dhe zakonet, për të përshkruar, për të krijuar marrëdhënie, për të hyrë në jetën aktive përmes studimit dhe punësimit, për të ndërvepruar, për të shprehur dëshirat, për të analizuar e argumentuar, për të mobilizuar dhe për t’u përfshirë në aksione të karakterit shoqëror.

**Rezultate të pritshme:**

- Të kuptojnë pikat kryesore të një diskutimi kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të njohura në punë, shkollë, kohë të lirë etj.;
- Të jetë autonom në shumicën e situatave që hasen gjatë udhëtimit në një rajon ku flitet gjuha e synuar;
- Të jetë në gjendje të prodhojë një ligjërime të thjeshtë dhe koherente për tema të njohura dhe në fushat e tij të interesit;
- Të dijë të tregojë një ngjarje, një përvojë ose një ëndërr, të përshkruajë një qëllim dhe të shpjegojë shkurtimisht arsyet ose shpjegimet për një projekt ose një ide.